

SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

Tabela .1

Nr.	Pozicio ni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervistë	Fillimi	Mbarimi
1	Shef Seksioni	Reparti Ushtarak nr.1012, Batalioni i Dytë i Këmbësores Aktiv dhe Rezervist, në Forcën Tokësore	Kukës	Pa afat	Po	Po	01.10.2024	15.10.2024

Formulari nr. 1

1.Pozicioni i punës: Shef Seksioni, në Seksionin e Financës.
2. Kodi i pozicionit: N/A
3. Reparti/Institucioni: Reparti Ushtarak nr.1012, në Batalionin e Dytë të Këmbësores Akvi dhe Rezervist, Kukës, në Regjimentin e Këmbësores së Jugut, në Forcën Tokësore.
4. Vendi: Tiranë
5. Paga: VKM nr.325, datë 31.05.2023, i ndryshuar.
6. Lloji i kontratës së punës: Pa afat
7. Data e fillimit të aplikimit: 01.10.2024
8. Data e mbylljes së aplikimit: 15.10.2024
9. Mënyra e aplikimit: Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes, në adresën www.mod.gov.al . Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës,do të dërgohet në: <i>Drejtorinë e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve</i> <i>Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës</i> <i>Tiranë</i>

10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e shkollës së lartë të noterizuar sëbashku me listë notash;
- fotokopje të patentës nëse ka;
- dëshmi profesioni nëse ka;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë dhe 9x12 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV)
- Letër motivimi
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike www.mod.gov.al. (linku: *Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit*)

11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë i/e dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- a. Grada/Titulli: **Shef Seksioni, (C3)**
- b. Arsimi : Të ketë diplomë të nivelit “Master Profesional ose Shkencor” në Shkencat Ekonomike/Financë.
- c. Kualifikimi: Të ketë kryer kualifikime/kurse të ndryshme në fushën që mbulon.
- d. Trajnimi: Të ketë përfunduar kursin e Financës programi ALPHA.
- e. Eksperienca në Punë: Eksperiencë pune nga **3 – 5 vjet** në fushën profesionale.
- f. Gjuha e huaj: Të ketë njohuri në gjuhën Angleze.
- g. Kërkesa të tjera specifike: Aftësi shumë të mira organizuese dhe drejtuese, si dhe të punës në grup dhe të përdor programeve kryesore të kompjuterit, Word, Excel, Power Point, Database dhe programin “ALPHA”.
- h. Niveli i certifikatës së sigurisë: Te plotësoje kriteret per tu pajisur me certifikate te sigurimit te personelit, sipas VKM nr.188/2015. Certifikate Sigurie “Secret”.

Përshkrimi i punës: Shefi i Seksionit të Financës, kontribuon për menaxhimin /realizimin/ kryerjen/ndjekjen e të gjithave aktiviteteve, detyrave, planeve për mbështetjen financiare të të gjithë veprimtarisë së repartit, në zbatimin e politikave financiare, me qëllim realizimin e të gjithë veprimtarisë së Repartit Ushtarak Nr.10.

Detyrat kryesore:

- Të sigurojë mbështetjen financiare në të gjitha veprimtaritë e b2k-së (RU-nr.1012) dhe seksioneve për të realizuar misionin e tyre.
- Është përgjegjës për zbatimin e rregullave që lidhen me menaxhimin financiar, dhe përgatitjen e pasqyrave financiare.
- Zbaton aktet ligjore dhe nënligjore për kontabilizimin e veprimeve financiare dhe materiale.
- Ndjek qarkullimin e mallrave, materialeve dhe artikujve të ndryshme të b2k-së në reparte dhe anasjelltas me dokumentacion të rregullt ,në sasinë e cilësinë e kërkuar sipas standardeve e kushteve teknike.
- Të organizojë e drejtojë kontrollat e brendshme ekonomiko – financiare.
- Menaxhon përdorimin me efektivitet të mjeteve dhe burimeve financiare, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
- Raporton në mënyrë periodike tek titullari i repartit duke e informuar në vazhdimësi lidhur me aktivitetin e seksionit.
- Të organizojë, bashkërendojë dhe bashkëpunojë me seksionet e tjera për hartimin real të projekt planeve ekonomiko-financiare.
- Të raportojë e të informojë tek Komandanti i b2k-së (RU Nr.1012), për rezultatet ekonomiko-financiare sipas periudhave të caktuara me bilance, evidenca, etje.
- Të përgatisë dokumentacionin për likuidim të shërbimeve me të tretët që operojnë me RU Nr. 1012, sipas ligjeve e vendimeve në fuqi.
- Të bëjë përlllogaritjen e shpenzimeve ekonomiko – financiare për emergjencat civile.
- Të përgatis informacione, evidenca dhe bilance për shpenzimet e realizuara gjatë gjithë vitit.

13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta.

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e Burimeve Njerëzore verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat

e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i dokumenteve të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin ejetëshkrimit (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;
- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;
- d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

Intervista zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin dhe aspiratat e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilit profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilit profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës.

Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerësohen në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë.

Kandidatët të cilët nuk marrin më shumë se **70 pikë**, (që përfshin vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, si dhe vlerësimin e intervistës), s'kualifikohen nga konkurimi.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.

